



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë,
Turizmit dhe Sipërmarrjes

Nr. 8885, datë 7/11 /2016



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Transportit dhe
Infrastrukturës

Nr. 5402, datë 24/11 /2016

UDHËZIM

PËR

KUSHTET DHE KRITERET QË DUHET TË PLOTESOJNË SUBJEKTET PËR TRANSPORTIN RRUGOR TURISTIK

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 63, pika 2 të ligjit nr. 93/2015 “Për turizmin”, nenit 3, pika 3.11 dhe nenit 25 të ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës,

UDHËZOJNË:

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Ky udhëzim ka për qëllim përcaktimin e kushteve dhe kritereve që duhet të plotësojnë subjektet për transportin rrugor turistik/të rastit të udhëtarëve brenda vendit dhe jashtë vendit.

Neni 2 Fusha e zbatimit

Ky udhëzim do të zbatohet për subjektet e transportit (fizikë/juridik) rrugor të udhëtarëve brenda vendit dhe ndërkombëtar, për tretë ose me qira dhe për transportuesit për llogari të vet, të cilët përdorin mjete të regjistruara në Shqipëri dhe të destinuar për transportin rrugor turistik/të rastit të udhëtarëve:

- a) me më shumë se nëntë persona përfshirë drejtuesin e mjetit, në veprimtarinë për tretë ose me qira;
- b) me më shumë dhe/ ose nëntë persona përfshirë drejtuesin, në veprimtarinë për llogari të vet.

Neni 3 Përkufizime

“Ligji për turizmin” është ligji nr. 93/2015 “Për turizmin”;

“Ligji për transportet rrugore” është ligji nr.8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar;

“Shërbime turistike/të rastit” janë shërbimet të cilat nuk i përgjigjen përkufizimit të shërbimeve të rregullta, përfshirë shërbimet e rregullta të specializuara, shërbimet vajtje-ardhje, sipas ligjit për transportet rrugore dhe ku karakteristika kryesore e të cilit është transporti i grupeve të udhëtarëve të krijuara më parë me iniciativë të të interesuarit ose të vetë transportuesit;

“Marrëveshja INTERBUS” është marrëveshja Europiane për transportin ndërkombëtar rrugor të rastit të udhëtarëve me autobus, në të cilën Shqipëria ka aderuar me ligjin nr. 9305, datë 04.11.2004.

KREU II KUSHTET DHE KRITERET

Neni 4 Kushtet

1. Shërbimet e turistike/ të rastit të udhëtarëve kryhen vetëm nga subjektet e transportit që zotërojnë një licencë në shërbimet e rregullta, sipas këtij udhëzimi dhe kuadrit ligjor përkatës në fuqi dhe të pajisur me librin e udhëtimit, si dhe përcaktimet në dispozitat e VKM nr. 1101, datë 28.12.2015 “Për miratimin e kushteve dhe përcaktimin e rregullave për transportin rrugor të nxënësve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe të studentëve”.

2. Shërbimet e rastit përfshijnë:

(a) Udhëtimet “me dyer të mbyllura”, që janë shërbimet e kryera me të njëjtin autobus që transporton të njëjtin grup udhëtarësh të formuar më parë, duke i kthyer në vendin e nisjes;

(b) Shërbimet që kryhen me udhëtimin e vajtjes plot dhe udhëtimin e kthimit bosh. Vendi i nisjes ndodhet në territorin ku transportuesi ka selinë.

(c) Shërbimet në të cilat udhëtimi i vajtjes kryhet bosh dhe të gjithë udhëtarët merren në të njëjtin vend. Udhëtarët janë dërguar më parë, nga i njëjti operator transporti, me kushtet e shkronjës “b” më sipër, dhe transportohen në territorin e bashkisë ku operatori i transportit ka selinë;

Në shërbimet e rastit, nuk lejohen të lihen ose të merren udhëtarë gjatë udhëtimit.

Përveç pajisjes me licencë dhe dokumentet e nevojshme të transportit, ndërmarrjet që kryejnë shërbime të rastit duhet të jenë të pajisur me një kontratë për çdo udhëtim me agjencitë udhëtimit/të transportit të licencuara.

Monitorimi i transportit turistik/të rastit, kryhet në vazhdimsi nga organet e kontrollit në rrugë në bashkëpunim me agjencitë e udhëtimit/të transportit.

Neni 5 Kriteret për transportin rrugor turistik/të rastit brenda vendit

1. Të jetë i licencuar për transport udhëtarësh në shërbimet e rregullta, sipas legjislacionit për transportin rrugor;

2. Dokumenti (Policë sigurimi) se pronari/ përdoruesi i mjetit të transportit ka lidhur kontratën e sigurimit, sipas ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar, i cili në transportin e udhëtarëve përfshin:

- i) sigurimin e udhëtarëve nga aksidentet në transportin publik;
- ii) sigurimin e përgjegjësisë së pronarit ose të përdoruesit të mjetit motorik, për dëmet shkaktuar palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti.

3. Certifikatën e kontrollit teknik të mjeteve rrugore, në përputhje me udhëzimin nr. 2, datë 11.3.2010, “Mbi kontrollin teknik të mjeteve rrugore”, të ndryshuar.

4. Aktin e vlerësimit në plotësimin e kushteve të komoditetit për autobusin në transportin e udhëtarëve, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR), sipas udhëzimit nr. 1649 datë 16.08.1999 “Mbi plotësimin e disa kushteve të veçanta në transportin rrugor të udhëtarëve”, të ndryshuar;

5. Drejtuesi i mjetit, të jetë i pajisur me Certifikatën e Aftësisë Profesionale përkatëse (CAP), në përputhje me udhëzimin nr. 3606/2, datë 28.10.2011 “Për pajisjen e përdoruesve të mjeteve rrugore të kategorive C, CE, D dhe DE, me certifikatën e aftësisë profesionale (CAP)”, të ndryshuar.

6. Në rastin kur mjetet janë me qira, qiramarrësi është përgjegjës për:

- (a) operimin në kushte të sigurta të mjetit të marrë me qira;
- (b) kryerjen e kontrolleve të duhura para përdorimit të mjetit dhe mirëmbajtjen e tij.

7. Kontrata e transportuesit /operatori turistik me agjencinë e udhëtimit/agjencinë e transportit.

Neni 6

Kriteret për transportin rrugor turistik/të rastit ndërkombëtar

Transporti turistik/i rastit ndërkombëtar i udhëtarëve, kryhet me anën e librit të udhëtimit, në bazë të marrëveshjes INTERBUS, (për shtetet palë në këtë marrëveshje). Për shtetet e tjera ky shërbim kryhet në përputhje me marrëveshjet dypalëshe.

Për të kryer transportin rrugor turistik/të rastit ndërkombëtar, transportuesi/operatori turistik të jetë i :

(a) licencuar për transport ndërkombëtar rrugor udhëtarësh sipas legjislacionit për licencat (ligji nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe VKM nr. 538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKL (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar).

(b) i pajisur me librin e udhëtimit sipas marrëveshjes INTERBUS, e cila lëshohet nga ANALTIR (Shoqata për Transportin Ndërkombëtar të Udhëtarëve).

2. Dokumenti (Policë sigurimi) se pronari/ përdoruesi i mjetit të transportit ka lidhur kontratën e sigurimit, sipas ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar, i cili në transportin e udhëtarëve përfshin:

- i) sigurimin e udhëtarëve nga aksidentet në transportin publik;
- ii) sigurimin e përgjegjësisë së pronarit ose të përdoruesit të mjetit motorik, për dëmet shkaktuar palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti.

3. Çertifikatën e kontrollit teknik të mjeteve rrugore, në përputhje me udhëzimin nr. 2, datë 11.3.2010, “Mbi kontrollin teknik të mjeteve rrugore”, të ndryshuar.

4. Aktin e vlerësimit në plotësimin e kushteve të komoditetit për autobusin në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve, lëshuar nga DPSHTRR, sipas udhëzimit nr. 1649, datë 16.08.1999 “Mbi plotësimin e disa kushteve të veçanta në transportin rrugor të udhëtarëve”, të ndryshuar;

5. Drejtuesi i mjetit të jetë pajisur me Certifikatën e Aftësisë Profesionale përkatëse (CAP), në përputhje me udhëzimin nr. 3606/2, datë 28.10.2011 “Për pajisjen e përdoruesve të mjeteve rrugore të kategorive C, CE, D dhe DE, me certifikatën e aftësisë profesionale (CAP)”, i ndryshuar.

6. Në rastin kur mjetet janë me qira, qiramarrësi është përgjegjës për:

(a) operimin në kushte të sigurta të mjetit të marrë me qira;

(b) kryerjen e kontroleve të duhura para përdorimit të mjetit dhe mirëmbajtjen e tij.

Një mjet i marrë me qira, që operon në shërbimet e rastit të transportit ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve dhe përdoret për të njëjtin qëllim, nuk ndryshon fushën e operimit për të cilën ai është pajisur me certifikatë, dhe ai nuk pajiset me certifikatë të re, për pasojë, mjeti operon me certifikatën e lëshuar për subjektin transportues që e ka dhënë atë me qira.

Kontrata e transportuesit (operatori turistik) me agjencinë e udhëtimit/agjencinë e transportit.

Neni 7

Detyrimet e subjektit transportues

1. Subjekti transportues i licencuar për kryerjen e transportit turistik/të rastit të udhëtarëve, do të marrë të gjithë masat për të garantuar kryerjen e këtij shërbimi dhe për plotësimin e kushteve dhe standardeve përkatëse të përcaktuara në këtë udhëzim.

2. Nuk mund të organizohet transporti turistik/të rastit, në qoftë se nuk është lidhur një kontratë me një agjenci udhëtimi.

3. Subjekti transportues është i detyruar të zbatojë legjislacionin në fuqi për personat me aftësi të kufizuar dhe t'i krijojë sa më shumë lehtësira për transportin e kësaj kategorie udhëtarësh. Mos zbatimi i legjislacionit në fuqi për transportin e personave me aftësi të kufizuar përbën shkelje të rëndë, e cila shkon deri në pezullimin ose heqjen e licencës dhe/ose certifikatës së autobusit.

Neni 8

Penalitetet

1. Në lidhje me kohën e drejtimit dhe periudhës së pushimit të drejtuesit të mjetit:

(a) Tejkalon:

i) maksimum 6 ditë pune ose prej një marzh 25% ose më shumë, dhe

ii) gjatë periudhës ditore të punës, maksimumin e limitit të kohës ditore të drejtimit prej një marzhi 50% ose më shumë pa marrë një pushim/ndërprerje ose pa një periudhë pushimi pandërprerë të paktën 4,5 orë.

(b) Cilido që shfrytëzon një mjet, i cili nuk operon në përputhje me licencën për transportin rrugor turistik/të rastit të udhëtarëve, ndëshkohet me masë administrative sipas shkronjës “b” të nenit 68 të Ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për Transportet Rrugore” të ndryshuar.

(c) Nuk ka një tahograf dhe/ose kufizuesin e shpejtësisë, ose duke përdorur një pajisje të

modifikuar e aftë të ndryshojë/të ndërhyje në regjistrimet e pajisjes regjistruese dhe/ose kufizuesin e shpejtësisë ose fletën e regjistrimi të falsifikuara ose të dhëna të ngarkuara/transferuar nga tahografi dhe/ose kartës së drejtuesit të mjetit.

2. Në lidhje me dokumentet e udhëtimit:

- (a) Drejton mjetin pa patur një certifikatë të vlefshme të kontrollit teknik dhe /ose me një difekt serioz, ndër të tjera sistemin e frenimit, sistemin e drejtimit, gomat, etj, që mund të krijojnë një rrezik të menjëhershëm për sigurinë rrugore.
- (b) Transporton mallra që janë të ndaluara për transport ose transporton mallra të tilla në mënyrë të ndaluar ose të pa aprovuar ose pa identifikuar ato në mjet, duke rrezikuar jetët e udhëtarëve ose mjedisin.
- (c) Transporton udhëtarë pa patur leje drejtimi të vlefshme ose transporti kryhet nga një subjekt transporti pa patur një licensë/certifikatë/autorizim të vlefshëm.
- (d) Drejton mjetin me një dokument të drejtuesit të mjetit të fallsikuar, ose me një dokument të një drejtuesi, i cili nuk është mbajtësi i saj, ose që ka qenë mbajtur mbi bazën e një deklarimi fals dhe /ose dokument të imituar.

Ky Udhëzim hyn në fuqi pas botimit ne Fletore Zyrtare.

**Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit,
Tregtisë dhe Sipërmarrjes**



Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës



**Model i librit të udhëtimeve për shërbimet e rastit brenda vendit
(Kapaku)**

- Emri dhe simboli i bashkisë
- Nr i librit

**Shërbimet turistik/të rastit të udhëtarëve brenda vendit
LIBRI I UDHËTIMIT**

Për shërbimet e turistike/të rastit në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit me autobus, në përputhje me:

Kreun II.2 të ligjit nr.8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar dhe Udhëzimin nr. _____, datë _____ “Për kushtet dhe kriteret që duhet të plotesojnë subjektet për transportin rrugor turistik”.

Emri i transportuesit:.....

Adresa:
.....

Numri i serisë së prodhimit të librit

.....
(Vendi lëshimit të librit)

.....
(Firma dhe vula e Autoritetit që lëshon librin)







SHËNIME TË RËNDËSISHME

1. Libri i udhëtimit ju lëshohet vetëm subjekteve të licencuar për të tretë dhe me qira në transportin e udhëtarëve.
2. Libri i udhëtimit jep të drejtën e kryerjes së shërbimeve të rastit brenda vendit, që janë:
 - udhëtimet me dyer të mbyllura ku i njëjti autobus do të transportojë të njëjtin grup udhëtarësh përgjatë gjithë udhëtimit dhe do t'i sjellë përsëri në pikën nga ku u nisën.
 - shërbime që kryejnë udhëtimin në vajtje me ngarkesë dhe udhëtimin e kthimit pa ngarkesë. Pika e nisjes është në vendin ku është vendosur operatori i transportit.
 - shërbime gjatë të cilave udhëtimi në vajtje është kryer pa ngarkesë dhe gjithë udhëtarët të transportuar më parë nga i njëjti operator transporti kanë kryer udhëtimin e kthimit në pikën e nisjes.
3. Informacion rreth plotësisimit të dokumentit të udhëtimit.
 - a) Për çdo udhëtim të kryer si një shërbim të rastit, operatori i transportit duhet të plotësojë një dokument udhëtimi në dy kopje, para nisjes së udhëtimit. Kopja e modelit të udhëtimit do të mbesë në ndërmarrje.
 - b) Fleta e parë e dokumentit të udhëtimit duhet të mbahet në autobus gjatë gjithë udhëtimit dhe do të paraqitet sa herë kërkohet nga organet e kontrollit.
 - c) Gjatë shërbimeve të rastit, asnjë udhëtar nuk mund të hipë ose të zbresë gjatë udhëtimit.
 - d) Transportuesi është i detyruar të sigurojë që dokumenti i udhëtimit është i plotësuar në mënyrën e duhur. Dokumenti i udhëtimit duhet të plotësohet me shkronja të mëdha shtypi dhe me bojë që nuk hiqet.
4. Libri i udhëtimit mban emrin e transportuesit dhe nuk është i transferueshëm.
5. Libri i udhëtimit përdoret për 25 udhëtime të shërbimeve të rastit.

DOKUMENTI I UDHËTIMIT PËR SHËRBIME TË RASTIT BRENDA VENDIT

Nr. i Librit:.....

Nr. i Listës së udhëtarëve. :.....

1	 Targa e autobusit	Numri i vendeve të udhëtarëve 			
2	 Emri ose emri tregtar i operatorit të transportit			
3	 Emri i drejtuesit ose drejtuesve të automjetit	1. 2. 3.			
Lloji i shërbimit (vini një kryq në kutinë e duhur dhe shtoni informacionin plotësues					
4	 Udhëtime me dyer të mbyllura <input type="checkbox"/>	 Udhëtimi i vajtjes me ngarkesë <input type="checkbox"/> Udhëtimi i kthimit pa ngarkesë <input type="checkbox"/> * Vendi ku kanë zbritur udhëtarët			
LISTA E UDHËTARËVE					
NR	EMËR MBIEMËR	NR	EMËR MBIEMËR	NR	EMËR MBIEMËR
1		19		37	
2		20		38	
3		21		39	
4		22		40	
5		23		41	
6		24		42	
7		25		43	
8		26		44	
9		27		45	
10		28		46	
11		29		47	
12		30		48	
13		31		49	
14		32		50	
15		33		51	
16		34		52	
17		35		53	
18		36		54	
VENDI DHE DATA E PLOTËSIMIT TË DOKUMENTIT TË UDHËTIMIT			FIRMA/ VULA E OPERATORIT TË TRANSPORTIT		
AUTORITETI KONTROLLIT					